

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ALBANIA OPPORTUNITIES" SHPK**

NENI 1 - EMËRTIMI SHOQËRISË

Prej shtetasit italian:

ETTORE LIVIO SERAFINI, lindur ne Romë (RM) - Itali me 21.08.1980 dhe banues ne Zvicër ne adresen: rruga Altanca Nr.35, 6776 Piotta; është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "ALBANIA OPPORTUNITIES" shpk.

NENI 2 - QENDRA E SHOQERISE

Shoqeria «ALBANIA OPPORTUNITIES » SHPK do te kete qendrën në Vlorë ne adresen: Lagje "Pavaresia", rruga "Ismail Qemali", kulla FERATI kati 2 dhe do te kete te drejte te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

Shoqeria mund te krijoje agjensi, zyra perfaqesimi, qendra dyesore ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

NENI 3 - KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne LEKE 100.000 (njëqindmijë lekë) dhe eshte teresish kapital finanziar i ortakut themelues. Ortaku i vetem eshte zoterues i një kuote me vlore te pergjithshme 100.000 LEKE (njëqindmijë lekë).

Me vendim te ortakut te vetem kapitali i shoqerise mund te rritet ne menyrat e parashikuara ligjore.

NENI 4 - KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin per nje periudhe 10 vjetesh.

Ajo do te jetë subjekt i te drejtës shqiptare qe nga data e regjistrimit te saj dhe do te ushtroje veprimtarine e saj deri me 01.03.2032.

Shoqeria mund te shkrihet vetem me vendim te ortakut te vetem.

NENI 5 - OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria do kete objekt te veprimtarise se saj aktivitetet vijuese:

Aktivitet ne fushen e shitblerjes, ristrukturimit dhe qiradhënisë së pasurive të paluaqitshme, të vetë shoqërisë dhe/ose të palëve të treta (pasuri me destinacion tregtar, rezidenciale dhe toka), si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj; mirëmbajtjen e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të ndërtesave duke përfshirë pastrimin e tyre;

promovim në internet nëpërmjet faqeve të WEB në sektorin e pasurive të paluajtshme për vete dhe/ose për palët e treta.

Shoqëria ka si objekt dytësor dhe/ose plotësues promovimin e Shqipërisë jashtë vendit dhe ofrimin e konsulencës tregtare e teknike dhe mbështetjen e nevojshme për sipërmarrësit apo kompanitë e huaja që synojnë të investojnë në Shqipëri dhe/ose në vendet ballkanike;

Aktivitetet tregtare mund te kryhen direkt apo ne formen e perfaqesive, si ne Shqiperi dhe jashtë saj, perfshire tregtine me shumice dhe me pakice. Shoqëria mund te kryeje te gjitha veprimet tregtare, industriale, te luajtshme te paluajtshme dhe te kryeje cfaredoloj aktiviteti tjeter te lejuar që konsiderohet i nevojshem per realizimin e objektit te aktvititetit te shoqerise. Gjithashtu shoqëria mund te marre pjese ne shoqeri dhe/ose ndermarrje te çdo natyre që kane objekt te te njejtë apo që lidhet me objektin e veprimitarise se shoqerise.


NENI 6 - ORGANET DREJTUESE

Administrator i shoqërisë për periudhën e parë 5 vjeçare duke filluar nga data e sotme deri më 01.03.2027 do jetë ortaku i vetëm ETTORE LIVIO SERAFINI.

Shoqëria «ALBANIA OPPORTUNITIES» SHPK do të jetë subjekt i te drejtës shqiptare dhe do të ushtroje aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe me normat e aktit themelues dhe të statutit bashkëngjitur.

Ky akt themelimi nënshkruhet prej meje ortakut themelues në datë 01.03.2022, duke deklaruar se njoh mirë gjuhën shqipe të shkruar e të folur.

ORTAKU THEMELUES /

ETTORE LIVIO SERAFINI


Vlorë, më 01 mars 2022 (dymijë e njëzet e dy)